



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria – Vlada - Government*  
*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe*  
*Inovacionit Ministarstvo Obrazovanja, Nauke,*  
*Tehnologije i Inovacija Ministry of Education, Science,*  
*Technology and Innovation*

*Kabineti i Ministres/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister*

Numër: 01B/317  
Datë: 20.10.2021

Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në mbështetje të Rregullores (QRK) - nr. 0272021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e datës 30.03.2021, nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4, shtojcës 1 paragrafi 7 dhe pikës 4.2 të Vendimit me Nr. 13-19 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 14.04.2021, nxjerrë këtë:

**Vendim**

**Për mundësinë e aplikimit për studentet nga viti i parë deri në të tretin dhe zgjatjen e afatit të aplikimit në thirrjen për mbështetje financiare për studentet vajza/gra në fushat STEM**

1. Thirrja për mbështetje financiare me nr.01B/248, për studentet vajza/gra që studiojnë në fushat e Shkencës, Teknologjisë, Inxhinierisë dhe Matematikës (STEM) në institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë përfshin të gjitha vajzat/gratë nga viti i parë deri në të tretin (I-III) sipas aneks-listës së programeve të publikuar me këtë vendim.
2. Zgjatet afati për aplikim deri më datën 31.10.2021 në orën 16:00.
3. Shtohet në aneks-listën e programeve për këtë thirrje programi Komunikacion dhe Transport.
4. Shfuqizohet pika e thirrjes me nr.01B/248 për nënshkrim të kontratës dhe deklaratës së zotimit. Pas përmbylljes së procesit të përzgjedhjes publikohet lista e fitueseve.
5. Vendimi hynë në fuqi me nënshkrimin e tij.

## A r s y e t i m

Duke u mbështetur në dispozitat e shënuara më lartë, thirrja për mbështetje financiare për studentet vajza/gra në fushat e Shkencës, Teknologjisë, Inxhinierisë dhe Matematikës (STEM) në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë tani përfshin edhe studentet e vitit dy dhe tre të nivelit baçelor dhe të njëjtës, i shtyhet afati për aplikim. Duke u bazuar në parimin e efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës shfuqizohet kërkesa e thirrjes që të nënshkruhet kontrata dhe deklarata e zotimit.

Po ashtu, duke u mbështetur në kërkesën e parashtruar nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës, të datës 24 Gusht 2021, për përfshirjen e programit Komunikacion dhe Transport, u vendos për përfshirjen e këtij programi në aneks-listën e programeve të përshtatshme për aplikim në këtë thirrje.

### Njoftimi u dërgohet:

1. Kabinetit të Ministres/MASHTI;
2. Zyrës së Sekretarit të përgjithshëm/MASHTI;
3. DALSH;
6. Arkivit/MASHTI.

Arbërie Nagavci

Ministre/MASHTI



## ANEKS-LISTA E PROGRAMEVE STEM

<b>Programet STEM</b>			
<b>Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"</b>			
<b>Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë</b>			
<i>Nr.</i>	<i>Programi</i>	<i>Kampusi</i>	<i>Niveli i studimeve</i>
1	Prodhimi Shtazor	Prishtinë	BSc
2	Prodhimi Bimor	Prishtinë	BSc
3	Teknologji Ushqimore me Bioteknologji	Prishtinë	BSc
<b>Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit</b>			
<i>Nr.</i>	<i>Programi</i>	<i>Kampusi</i>	<i>Niveli i studimeve</i>
4	Inxhinieria e mjedisit	Prishtinë	BSc
5	Konstruktiv	Prishtinë	Bsc
6	Hidroteknik	Prishtinë	BSc
7	Gjeodezi	Prishtinë	BSc
<b>Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike</b>			
<i>Nr.</i>	<i>Programi</i>	<i>Kampusi</i>	<i>Niveli i studimeve</i>
8	Elektronikë, Automatikë dhe Robotikë	Prishtinë	BSc
9	Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit	Prishtinë	BSc
10	Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike	Prishtinë	BSc
<b>Fakulteti i Matematikës dhe Shkencave të Natyrës</b>			
<i>Nr.</i>	<i>Programi</i>	<i>Kampusi</i>	<i>Niveli i studimeve</i>
11	Biologji	Prishtinë	BSc
12	Kimi	Prishtinë	BSc
13	Kimi Inxhinierike	Prishtinë	BSc
14	Shkencë Kompjuterike	Prishtinë	BSc
15	Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit	Prishtinë	BSc
16	Gjeografi	Prishtinë	BSc
17	Fizikë	Prishtinë	BSc
18	Matematikë	Prishtinë	BSc
<b>Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike</b>			
<i>Nr.</i>	<i>Programi</i>	<i>Kampusi</i>	<i>Niveli i studimeve</i>
19	Mekatronikë	Prishtinë	BSc
20	Komunikacion dhe Transport	Prishtinë	BSc
21	Termoenergjetika dhe Energjia e Ripërtërishme	Prishtinë	BSc
22	Dizajn Inxhinierik dhe Automjete	Prishtinë	Bsc



<b>Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini"</b>			
<i>Nr.</i>	<i>Programi</i>	<i>Kampusi</i>	<i>Niveli i studimeve</i>
23	Teknologji	Mitrovicë	Bsc
24	Inxhinieri dhe tekonologji ushqimore	Mitrovicë	Bsc
25	Xehtari	Mitrovicë	Bsc
26	Gjeologji	Mitrovicë	Bsc
27	Materiale dhe Metalurgji	Mitrovicë	Bsc
28	Inxhinieri Ekonomike	Mitrovicë	Bsc
29	Makineri Prodhuese	Mitrovicë	Bsc
30	Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri	Mitrovicë	BSc
<b>Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka"</b>			
<i>Nr.</i>	<i>Programi</i>	<i>Kampusi</i>	<i>Niveli i studimeve</i>
31	Agromjedis dhe Agroekologji	Pejë	BSc
32	Teknologji Ushqimore	Pejë	BSc
33	Teknologji e Prodhimit Bimor	Pejë	BSc
<b>Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti"</b>			
<i>Nr.</i>	<i>Programi</i>	<i>Kampusi</i>	<i>Niveli i studimeve</i>
34	Dizajn Softueri	Prizren	BSc
35	Teknologji Informacioni dhe Telekomunikimi	Prizren	BSc
36	Teknologji Informacioni dhe Telekomunikimi - Boshnjakisht	Prizren	BSc
37	Teknologji Informacioni dhe Telekomunikimi - Turqisht	Prizren	BSc
38	Shkencat e Pyjeve dhe të Mjedisit	Prizren	BSc
39	Agrobiznes	Prizren	BSc
<b>Universiteti i Gjilanit "Kadri Zeka"</b>			
<i>Nr.</i>	<i>Programi</i>	<i>Kampusi</i>	<i>Niveli i studimeve</i>
40	Shkenca Kompjuterike	Gjilan	BSc
<b>Universiteti i Shkencave të Aplikuara, Ferizaj</b>			
<i>Nr.</i>	<i>Programi</i>	<i>Kampusi</i>	<i>Niveli i studimeve</i>
41	Inxhinieria Industriale me Informatikë	Ferizaj	BSc
42	Informatika e Aplikuar	Ferizaj	BSc